



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK



“ PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR 2023”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 16.12.2022 pasi shqyrtoi materialin e relatuar nga Kryetari i Bashkisë “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023”, në mbështetje të ligjit nr.9936 dt 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar , ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 68/2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri”, ligjit 79/2017 “Për sportin”, ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr 1108, date 30.12.2015 “Për transferim nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të bashkisë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit, VKM nr 915, date 11.11.2015 “Për transferim në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkive, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme të ndërmarjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve” VKM nr 433, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje, kullotave publike sipas inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave”, VKM nr 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr 158, datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendimit nr 604, datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, dhe shkresën nr 21863, datë 24.11.2022 nga MFE me objekt “Mbi hartimin e PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023, për bashkitë pilot (Gjirokastrë, Korçë, Mirditë)”, shkresës nr 19206, datë 19.10.2022 nga MFE me objekt “Dërgohet për njoftim transferi të pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”.



VENDOSI:

1. Të miratojë buxhetin e Bashkisë Gjirokastër për vitin 2023 sipas përcaktimit të nentit 40, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
2. Të mirtoj treguesit e buxhetit 2023 si më poshtë
 - I
 - A- Të ardhura gjithësej705 990
 - A.1 Të ardhurat e veta të planifikuara për 2023.....230 477
 - B- Transferta gjithësej.....475 513
 - B.1 Transferta e përgjithshme e pakushtëzuar.....253 364
 - B.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale.....222 149
 - II
 - A- Shpenzime personeli..... 462 249
 - B- Shpenzime mallra dhe shërbime..... 134 636
 - C- Transfertë Akademisë së Futbollit Luftëtari15 000
 - D- Fondi rezervë..... 4 162
 - E- Fondi kontigjencës.....4 162
 - F- Fondi emergjencës nga të ardhurat e veta.....2 000
 - G- Shpenzime kapitale..... 83 781
3. Për kompetencë të kryetarit të bashkisë
 - a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program.
 - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve koherente, brenda të njëjtit program, (600-601-602).
 - c) Përdorimi i fondit të veçant sipas legjislacionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

LAVDI HASANI